

UDHËZIM
Nr.243 , datë 22.4. 2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR.160, DATË 25.1.2007
"PËR PROCEDURAT E NDALIMIT, SEKUESTRIMIT DHE KONFISKIMIT TË
MJETEVE PËR KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 201, 203, 206, 209, 210 e 211 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", nenit 7 të ligjit nr. 7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000, rregullores "Për zbatimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, me qëllim unifikimin e procedurave për sekuestrimin, konfiskimin dhe tjetërsimin e mjeteve,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 5 dhe 13, pas fjalëve "Rezervave" të shtohen fjalët "Materiale".
2. Pas pikës 5, të shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:
"5.1 Në administrim për shitje, të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, kalojnë edhe mjetet, ndalimi i të cilave është bërë sipas nenit 203 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar."
3. Germa "a" e pikës 8 të ndryshohet si më poshtë:
"a) Shefi i Sektorit të Rendit të Policisë së Qarkut – kryetar;"
4. Pika 8/2 shfuqizohet.
5. Pas pikës 8/3, të shtohet pika 8/4, me këtë përmbajtje:
"4. Përcaktimin e peshës reale të mjeteve me mangësi të dukshme."
6. Fjalja e parë e pikës 9 ndryshohet si më poshtë vijon:
"9. Mjetet e kategorizuara sipas pikës 8/3, u shiten shoqërive të licencuara për shkatërrim mjetesh, për skrap ose për shkrirje metalesh, pasi të hiqen nga qarkullimi, sipas nenit 102 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar."
7. Pika 11 ndryshohet si më poshtë vijon:
"11. Transportimi i mjeteve të kategorizuara sipas pikës 8/1, për në Rezervat Materiale të Shtetit, bëhet me mjetet e Ministrisë së Brendshme.
Transportimi i mjeteve të kategorizuara sipas pikës 8/3, bëhet nga Blerësi Publik."
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij edhe për mjetet e konfiskuara deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani